



Ne baze të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 24, paragrafit 1 dhe 2, lidhur me nenin 25, të Ligjit Nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019”, e konform nenit 29, lidhur me nenin 31, të Rregullores (QRK) Nr. 09 /2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës dhe neneve 15 dhe 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë -----, miraton këtë:

Projekt-V E N D I M Për këmbimin e pronës komunale me pronën private

Neni 1

MIRATOHET; propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme publike komunale me pronat e paluajtshme private për interes publik.

1.1 Pronat e paluajtshme komunale të cilat i **jepet** në emër të këmbimit personit fizik; Sevdije (Osman) BERISHA nga Suhareka, Rr. Brigada 123” është: **Pjesa e parcelës** kadastrale **P-72116046-01211-1** sipas certifikatës së pronës Nr. 579/2029 e datës 02.07.2026, zona kadastrale Suharekë, vendi i quajtur “Pojata” e evidentuar në emër të “Komuna e Suharekës”, me sipërfaqe të përgjithshme prej **S=2286m²**, nga sipërfaqja e përgjithshme për këmbim i jepen përkatësisht, **S=55m²** dhe **Pjesa e parcelës** kadastrale **P-72116046-02816-9** sipas certifikatës së pronës Nr. 579/2029 e datës 02.07.2026, zona kadastrale Suharekë, vendi i quajtur “Pojata” e evidentuar në emër të “Komuna e Suharekës”, me sipërfaqe të përgjithshme prej **S=479m²**, nga sipërfaqja e përgjithshme për këmbim i jepen përkatësisht, **S=84m²** në pronësi dhe posedim të personit fizik të lartcekur **në total 139m²** për këmbim.

1.2 Ndërsa pronat e paluajtshme private të cilat merren në emër të këmbimit në pronësi dhe posedim të Komunës së Suharekës janë; **1. Pjesa e parcelës** kadastrale **P-72116046-01212-1** sipas certifikatës së pronës Nr.579-2029 e datës 02.07.2026, me sipërfaqe të përgjithshme prej **S=2765m²** nga sipërfaqja e përgjithshme për këmbim jepen **S=55m²**, zona kadastrale Suharekë, vendi i quajtur “Pojata” e evidentuar në emër të Sevdije (Osman) BERISHA nga Suhareka Rr. “Brigada 123” dhe **2. Pjesa e parcelës** kadastrale **P-72116046-01212-1** sipas certifikatës së pronës Nr.1491/2025 e datës 20.03.2025, me sipërfaqe të përgjithshme prej; **S=2765m²**, nga sipërfaqja e përgjithshme për këmbim jepen **S=122m²**, zona kadastrale Suharekë, vendi i quajtur “Pojata” e evidentuar në emër të Sevdije (Osman) Berisha nga Suhareka, **në total 177m²** për këmbim.

Neni 2

Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë pasi që nuk ekziston parcelë tjetër komunale të përshtatshme për realizimin e “Planit Zhvillimor Komunal në Suharekë” dhe “Hartës Zonale të Komunës”, konkretisht **Rregullimi infrastrukturës në rrugën “Luigj Nikolla” në qytetin e Suharekës.**

Neni 3

OBLIGOHET-Drejtoria për shërbime pronësore juridike dhe kadastër, që të zhvilloj të gjitha procedurat ligjore, konform dispozitave të nenit 25, të Ligjit Nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr. 10/2019.

Neni 4

Pronat e këmbyer nga personi Juridik dhe personi fizik të cekur në neni 1, të këtij vendim mundet të barten në librat kadastral, pas lidhjes dhe nënshkrimit të kontratës në mesë Kryetarit të Komunës dhe pronarëve të parcelës kadastrale që këmbëhet, me të cilën kontratë përcaktojnë kushtet, kriteret dhe mënyrën e bartjes.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, përkatësisht Drejtoria për shërbime pronësore juridike dhe kadastër e Komunës së Suharekës.

Neni 6

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, (QRK) Nr. 03/2026, për procedurat e shqyrtimit administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-_____
Me datë_____

Kryesuesi Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI